



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2020:023895  
Datë: 30.09.2024  
Numri i dokumentit: 06225029

Pml.nr.538/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit A.M., nga fshati ., komuna e Gj., për shkak të veprës penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.117/2020, të datës 27.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1624/2023, të datës 27.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 12.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.117/2020, të datës 27.07.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1624/2023, të datës 27.05.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.117/2020, e datës 27.07.2023, të dënuarin A. M., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhja e shërbimeve”, nga neni 314, paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve, kurse në bazë të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e

të dënuarit, dënimi me burgim është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej dymijepesëqind (2,500.00) euro, i cili dënim do të ekzekutohet, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë dhe do të paguhet në pesë (5) rata të barabarta. Pala e dëmtuar, përkatësisht KEDS-Distrikti në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil. Nëse i dënuari refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje që të paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e dënuarit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i dënuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë do të caktohet nga një (1) ditë burgim. Është detyruar i dënuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën njëzet (20) euro, si dhe shumën prej njëzet (20) euro të emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1624/2023, e datës 27.05.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit, avokati Elmi Qerimi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1, nën-paragrafi 10 dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. lidhur me nenin 368, si dhe nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 4, 6 dhe 7 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që këto aktgjykime të anulohen, ndërsa kjo çështje penale t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.314/2024, e datës 05.09.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. M., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi e vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit A. M., në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet e lartcekura, në radhë të parë, për faktin sepse seanca e shqyrtimit gjyqësor, kur edhe është shpallur aktgjykimi është mbajtur më datën 27.07.2023, ndërsa aktgjykimi në formë të shkruar, mbrojtësit të të dënuarit i është dorëzuar më datën 31.10.2023, ndërsa sipas dispozitave ligjore, aktgjykimi është dashur që të përpilohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, ndërsa për një vonesë të tillë të përpilimit të aktgjykimit, nuk është marrë leje nga kryetari i gjykatës.

Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës me gjendjen faktike dhe me faktet vendimtare që janë prezantuar në arsyetimin e aktgjykimit dhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, kurse në anën tjetër, analizimi dhe vlerësimi i provave nuk është bërë në mënyrën e duhur, në veçanti provat që shkojnë në favor të të dënuarit, kurse provat tjera janë përshkruar në mënyrë të përgjithësuar, ndërsa në dispozitiv të aktgjykimit nuk janë përshkruar në mënyrë konkrete veprimet inkriminuese të veprës penale.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me faktet vendimtare, si dhe nuk është vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësia e provave kundërthënëse dhe arsyet e mosmiratimit të propozimeve konkrete të mbrojtjes.

Gjithashtu, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktakuza nuk është ngritur në harmoni me dispozitat ligjore, pasi që nuk janë zhvilluar hetime dhe i dënuari asnjëherë nuk është dëgjuar më parë, qoftë nga policia apo nga prokurori i shtetit, ndërsa kur i dënuari është deklaruar për herë të parë në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.07.2023, i njëjti e ka identifikuar dhe ka theksuar se kryerës i kësaj vepre penale është A. H., ish dhëndëri i tij-burri i motrës së tij, i cili ka pasur të instaluar pajisje për riprodhimin e kriptovalutave në objektin e marrë me qira prej qiradhënësit B. D., e që një gjë e tillë ka mundur të shihet edhe nga video-incizimi i CD-së që është administruar si provë në shqyrtim gjyqësor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të dënuarit A. M., janë të pabazuara, pasi që aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Dispozitivi i aktgjykimeve të kundërshtuara është i kuptueshëm dhe i qartë, si dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin e tyre, por njëkohësisht edhe me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilave gjykata e shkallës së parë ju ka falur besimin.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përpiluar konform dispozitave të nenit 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364 të KPP-së, ngase në të janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari. Në anën tjetër, në arsyetimet e aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta janë paraqitur arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale, të cilat bazohen në dispozitat e nenit 369, paragrafi 6 të KPP-së, ku gjykatat në fjalë kanë paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, si ato faktike, ashtu edhe ato juridike.

Aktgjykimet e kundërshtuara janë të bazuara në prova të ligjshme dhe të pranueshme e të cilat si të tilla janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku nga shkresat e lëndës dhe procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor shihet se janë administruara një sërë provash, siç është bërë dëgjimi i dëshmitarëve: V. H., B. B., A. L., M. H., Sh. H., B. A., pastaj provat

materiale: procesverbalet, futura, fotografitë e objektit, transaksionet e konsumatorit në emër të të dënuarit, video incizimi, dhe mbrojtja e të dënuarit.

Gjithashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, edhe pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se nuk janë dhënë arsyet e qarta lidhur me faktet vendimtare, nuk qëndrojnë, ngase gjykatat e instancave më të ulëta kanë paraqitur arsye për të gjitha këto çështje dhe kanë marrë për bazë edhe kanë administruar edhe prova tjera të propozuar nga mbrojtja, ku pas analizimit dhe analizimit të të gjithave këtyre provave, kanë ardhur në përfundim se i dënuari ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar.

Meqenëse në këtë rast janë administruar disa prova, siç u theksua edhe më lart, nga shkresat e lëndës rrjedh që gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë të duhur edhe saktësinë e provave kundërthënëse, si provave që i kishte propozuar prokurori i shtetit, ashtu edhe të provave që i kishte propozuar mbrojtja dhe atë: deklaratimet e dëshmitarëve: M. H., Sh. H., B. A., provat materiale, duke përfshirë këtu edhe video-incizimin, si dhe mbrojtjen e të dënuarit A. M., i cili e kishte mohuar kryerjen e kësaj vepre penale, duke shtuar se në këtë rast kishte qenë i përfshirë ish-dhëndëri i tij. Mirëpo, një pretendim i tillë i të dënuarit, nuk ishte pranuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, me arsyetimin se me provat tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ishte vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë përgjegjësia penale e të dënuarit. Në këtë drejtim, nga shkresat e lëndës, si dhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, del që dëshmitarët: V. H., B. B., A. L., që të tre punëtorë të KEDS-it, kanë sqaruar në mënyrë të mjaftueshme rrjedhën e tërë ngjarjes, që nga dita kur kanë shkuar në fshatin ..., komuna e Gj., ku kanë konstatuar se objekti përkatës kishte qenë duke shpenzuar energji elektrike që kishte rezultuar me shpenzime mbi normë, të cilat shpenzime nuk janë regjistruar si shpenzime të krijuara, e deri në ditën kur i dënuari A. M., e kishte nënshkruar procesverbalin për instalimin e njëhisorit elektrik në emër të tij, ku tek pjesa e komentit, është cekur “se nëse vërtetohet se keni patur shifër të vjetër (njehsor të vjetër) me borxh, atëherë ky borxh do të bartet në shifrën e re (njehsorin e ri), shifra e vjetër do të pasivizohet”. Në këtë mënyrë, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 14.03.2023, del që dëshmitari V. H., përveç tjerash kishte sqaruar se pronar i objektit kishte qenë B. D., ku pas interesimit e kishin gjetur shtëpinë e tij dhe dikush përmes telefonit, e kishte informuar se këtë objekt ja kanë dhënë me qira A. M., kurse pasi që i kanë gjetur të dhënat e tij, pas pesë (5) ditëve, përkatësisht më datën 15.08.2019, të njëjtit e kanë montuar njëhisorin elektrik në këtë objekt, ku objektin e ka hapur A. M., dhe gjithashtu edhe procesverbalin me konstatimin e lartcekur e kishte nënshkruar A. M. Dëshmitari në fjalë kishte theksuar se pasi që e kishin kuptuar se kush po e shfrytëzon objektin, e kishin thirrur shfrytëzuesin dhe kanë konstatuar se shfrytëzuesi është A. M., i cili ja kishte sjellë letërnjoftimin dhe e kishte pranuar se e shfrytëzon me qira këtë objekt, ku edhe në bazë të deklaratimit të tij, ora e energjisë elektrike është regjistruar në emër të tij. Përveç këtyre, nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, shihet që edhe dëshmitari tjetër A. L., ka pohuar se një grua te shtëpia e B. D., i cili ishte në Zvicër, i ka treguar se objekti ju ka dhënë me qira A. M., ndërsa pas pesë (5) dite kur janë takuar me A. M., i njëjti e kishte konfirmuar se ai e shfrytëzon këtë objekt. Referuar deklaratimeve të këtyre dëshmitarëve, por edhe provave tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezulton se arsyetimet e gjykatave të instancave më

të ulëta në drejtim të përgjegjësisë penale të të dënuarit janë të drejta dhe gjejnë mbështetje në shkresa të lëndës.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të bazuar pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit për mos respektimin e afatit ligjor për përpilimin me shkrim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimi në fjalë është marrë më datën 27.07.2023, ndërsa është përpiluar me shkrim më datën 29.09.2023, çka do të thotë që është tejkaluar afati ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve për përpilimin me shkrim të aktgjykimit, sipas nenit 368, paragrafi 1 të KPP-së, afat ky që llogaritet nga dita e shpalljes së aktgjykimit, mirëpo një gjë e tillë, në rastit konkret, nuk konsiderohet shkelje e natyrës së tillë që do të mund të kishte ndikim në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e këtij aktgjykimi, ashtu siç është parashikuar në nenin 384, paragrafi 2 të KPP-së.

Edhe pretendimi i mbrojtësit për mos zbatimin e hetimeve dhe ngritjen e aktakuzës në mënyrë të drejtpërdrejt konsiderohet i pabazuar, pasi që aktakuza është ngritur më datën 14.02.2020, në kohën kur ka qenë në fuqi Kodi i mëparshëm i Procedurës Penale (Kodi Nr.04/L-123), ndërsa në nenin 101, paragrafi 2 të këtij Kodi, ishte parashikuar mundësia e ngritjes së aktakuzës në mënyrë të drejtpërdrejt, pra pa zbatim të hetimeve, në rastet kur bëhet fjalë për vepra penale të dënueshme me më pak se tre (3) vjet, kurse për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari është parashikuar dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Kjo do të thotë se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për shkelje të dispozitave ligjore në këtë drejtim, pasi që me dispozitat ligjore të Kodit të lartcekura ka qenë e lejuar edhe ngritja e aktakuzës në mënyrë të drejtpërdrejtë, përkatësisht pa zbatim të hetimeve, nëse është bërë fjalë për vepra penale të dënueshme me burgim deri në tre (3) vjet.

Në fund, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.538/2024, më datë 12.09.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,  
Agim Maliqi